

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALMARJOB” SHPK

Ortaku themelues si më poshtë:

- **Z. ARMIR ALLARAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Isait, lindur më 01.02.1980 në Kukës dhe banues në Tiranë në adresën Rr Arben Broci Nr 50 Paskuqan Bashkia Kamez, Tiranë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Kartes Identitetit Nr. 031419394 dhe nr personal I00201210P;

bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, sot më datë 07.11.2018, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin ALMARJOB SHPK.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm) të shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare ALMARJOB SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar ALMARJOB SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Rruga Gjergj Kastrioti Pallati Euro 3D Mezes Fushe Njesia Kashar-Tiranë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në:

- Sherbime në fushën e punësimit
- Sherbime në fushën e marketingut, konsulencë në organizime shoqërore dhe sherbime logjistike
- Sherbime për nevojat individuale dhe shoqërore në fushat e sherbimeve të pronave të pa-tundeshme, sherbimeve elektrike, mekanike, hidraulike, ushqimore.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë ALMARJOB SHPK do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare ALMARJOB SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

Armir Allaraj
AA

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakut

7.1 Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë ALMARJOB SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij, që përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ALMARJOB SHPK është 10.000 (dhjetëmijë) lekë .

8.2 Ortaku i Vetëm i shoqërisë është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë 10.000 (dhjetëmijë) lekë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

8.3 Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm Z.Armir Allaraj.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm)
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).


Afati i emërimit të administratorit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

Administrator i parë i Shoqërisë është Z. Armir Allaraj.

Ky akt themelimi hartohet dhe firmoset në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një origjinale qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Armir Allaraj


Armir Allaraj